

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

KRIJON

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K12023001A

NUIS/NIPT

Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044

Adresa

Tiranë

Albania

1044

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0694047451

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@krijon.al

E-mail

Administrator Xhuljana Braha

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/09/13

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0686387635

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-17819-09-03-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Operatori i Blerjeve të Perqendruara

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

43942150

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/10/04

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/10/04

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/22768/09032024

35000000-5

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

Vendim 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Në datën 04.09.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference REF-17819-09-03-2024, me objekt “Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit” me fond limit 43,942,150 (dyzet e tre milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH dhe datë zhvillimi 04.10.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Në Dokumentet Standarde të Tenderit, konstatoam disa parregullsi, kritere të paqarta, si dhe të pajustificuara ligjërisht, të cilat nga njëra anë shkaktojnë konfuzion tek operatori ekonomik dhe nga ana tjetër kufizojnë artificialisht konkurrencën e lirë, duke zvogëluar mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Së pari, referuar legjislacionit të prokurimit publik, Shoqëria “Krijon” sh.p.k ka “prima facie” interes për të paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi, pasi është operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në tender dhe paqartësitë e Dokumenteve të Tenderit çenojnë mundësinë tonë për sukses në procedurën e prokurimit.

Së dyti, referuar nenit 110 të LPP, pika 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”, Shoqëria “Krijon” sh.p.k dërgon ankesën në përputhje me afatin e përcaktuar ligjor.

Së treti, bazuar në nenin 96 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika 1 “Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.” Dhe neni 100 “Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”, e dorëzojmë ankesën tonë, në respektim të kushteve formale të saj.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

1. Në dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht në piken 2.3 Kapaciteti teknik, pika 4 Autoriteti Kontraktor ka cituar:

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi/ distributor i autorizuar, se

afati garancisë së mallrave objekt prokurimi është 2 (dy) vjet nga dorëzimi pranë autoritetit kontraktor, si dhe gjatë këtij afati operatori ekonomik merr përsipër me kostot e tij shërbimin e riparimit për defektet e mundshme nga prodhimi.

Së pari, gjykojmë se autoriteti kontraktor nuk duhet të përcaktojë kritere që mbivendosen dhe për më tepër shkaktojnë konfuzion e paqartësi tek operatorët ekonomikë të interesuar.

Kërkesa për një deklaratë garancie nga kompania prodhuese ngarkon me përgjegjësi një kompani e cila në fakt nuk është pjesëmarrëse në këtë procedurë tenderimi. Detyrimi i garancisë në fakt duhet të jetë e operatorit ekonomik fitues dhe jo e kompanisë prodhuese/distributore e cila në fakt bën të mundur vetëm shitjen e produktit.

Kompania Prodhuese ngarkohet më përgjegjësi vetëm ndaj operatorit ekonomik që do të furnizohet me artikujt objekt prokurimi.

Detyrimin për një deklaratë garancie ndaj autoritetit kontraktor duhet ta ketë vetëm operatori ekonomik fitues i cili do të nënshkruajë kontratën e furnizimit.

Së dyti, në procesverbalin e argumentimit, autoriteti kontraktor ka cituar:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.

Nga sa më sipër, autoriteti kontraktor ka theksuar se kërkon të ngarkoje me përgjegjësi operatorin ekonomik dhe jo prodhuesin ose distributorin. Operatori ekonomik nënshkruan kontratën e furnizimit dhe si rrjedhim mbart të drejta dhe detyrime kundrejt autoritetit kontraktor. Nëse operatori ekonomik merr përsipër të deklarojë se periudha e garancisë se artikujve objekt prokurimi është 2 vjet, atëherë autoriteti kontraktor krijon bindjen mbi aftësinë e operatorit për realizimin me sukses të kontratës.

Nga sa më sipër kërkojmë që autoriteti kontraktor të ndryshojë këtë kriter duke kërkuar që deklarata e garancisë të paraqitet nga operatori ekonomik fitues dhe jo nga prodhuesi ose distributori i artikujve objekt prokurimi. Gjatë afatit të garancisë operatori ekonomik merr përsipër edhe shërbimin dhe riparimin e difekteve.

2. Në dokumentet Standarte të Tenderit, konkretisht pika 7 autoriteti kontraktor citon:

7.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të pakten një inxhinier informatik/ elektrik/elektronik/mekatronik/fizik/ mekanik/ ndertimi të trajnuar, për pajisjet e meposhtme / ose ekuivalente me to

1.Presa automatike multifunksionale për betonin

2.Prese për provat në terheqje të çelikut dhe përcaktimin e rezistencës në perkulje të çelikut

3.Pajisje për testimin e Tombinove.

Për inxhinierin duhet të paraqitet:

- Diplomë sipas profilit Inxhinier Informatik/Elektrik/Mekatronik/Fizik/Mekanik/Ndertimi;
- CV

- Kontrate individuale pune;
- Certifikatë trajnimi e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ose autoritete / ente të tjera, të autorizuar për lëshimin e certifikatave të formimit profesional / ose ekuivalent, në përputhje me natyrën e pajisjeve më sipër në kriterin nr. 7.

Gjykojmë kërkesa juaj për staf të pajisur me certifikata trajnimi nga prodhuesi/distributri apo ente të tjera të autorizuar, nuk stimulon pjesmarrjen gjithpërfshirëse të operatorëve ekonomikë. Për më tepër çënon parimin e mosdiskriminimit dhe bazarzisë në ndërmjet operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi.

Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë që të nxisin pjesmarrjen dhe konkurrencën, të stimulojnë pjesmarrje të gjërë, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.

Së pari, marrë parasysh se është një procedurë mbi kufirin e lartë monetar, kanë të drejtë të marrin pjesë edhe kompani të huaja të cilat janë prodhues të artikujve objekt prokurimi dhe si rrjedhim kanë të punësuar staf të trajnuar për pajisjet, duke përjashtur në mënyrë të drejtpërdrejtë operatorë ekonomikë vendas që mund të realizojnë me sukses kontratën e furnizimit.

Së dyti, artikujt objekt prokurimi janë pajisje të një natyrë te vecantë dhe është e pamundur që operatori ekonomik të ketë staf të trajnuar dhe që disponojnë certifikata trajnimi për pajisje “ekuivalente”. Pavarësisht se është cituar termi ekuivalente, në realitet nuk ekziston dicka e tillë. Në rast se komisioni i shqyrtimit të ankesave do të refuzojë pretendimin tonë, lutemi tna japë emrin e pajisjeve ekuivalente. Operatori ekonomik pjesmarrës bashkëpunon me kompaninë prodhuese e cila bashkë me artikujt vë në dispozicion edhe inxhinierë të kualifikuar dhe trajnuar.

Së treti, kompanitë prodhuese, për pajisjet e këtyre standartave kanë kriter që instalimi të kryhet nga inxhinierët e tyre në mënyrë që të garantojnë standartet e deklaruar të pajisjes. Nëse instalimi i pajisjes nuk bëhet nga inxhinierët e trajnuar të tyre, prodhuesi nuk mban garanci.

Nga sa më sipër, gjykojmë se kriteri për staf të trajnuar dhe certifikuar nga operatori ekonomik çënon konkurrencën mes operatorëve ekonomikë dhe favorizon pjesmarrjen e operatorëve të huaj përballë atyre vendas.

Kërkojmë që operatorit ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ti lejohet të deklarojë dhe marrë përsipër që procesin trajnimit të stafit ta realizojë ndërmjet inxhinierëve dhe stafit të trajnuar të kompanisë prodhuese nga e cila do të furnizojë artikujt objekt prokurimi.

3. Në lidhje me specifikimin “Pajisja duhet të jete sipas standarteve” të kërkuara në këtë procedurë prokurimi për artikujt, 1,2,3,4,14,18,19,20,21,23,24,25,27,28,33.

Sqarojmë që një pjese e standarteve të kërkuara janë standarte lokale që aplikohen vetëm në shtete të caktuara ose janë standarte ekuivalente të standarteve EN të kërkuara ose janë standarte të aksesoreve të ndryshëm që mund të konfigurohet pajisja por që nuk përfshihen në konfigurimin e pajisjeve të kërkuara nga autoriteti sipas specifikimeve në DST.

Prodhues të ndryshëm të cilët prodhojnë artikujt e kërkuar sipas standarteve EN/ISO dhe standarteve të nevojshme të aplikueshme në testimet që do të kryhen në laboratorin e In.Ndërtimit sipas kërkesave të standarteve kombëtare për testimin e materialeve, nuk i citojnë të gjitha standartet e kërkuara në broshurat ose data sheet-et e pajisjeve.

Për këtë arsye, kërkojmë që të rregullohen kërkesat për standartet duke u fokusuar vetëm në standartet e detyrueshme SSH/EN ose ISO ose ekuivalente të cilat aplikohen sipas legjislacionit shqipëtar. Në këtë mënyrë në si operator ekonomik i interesuar do të kishim më të qartë ofertën që do të paraqesim dhe aksesoret që duhet të ofertojmë. Për të rritur konkurrencën dhe pjesëmarrjen e sa më shumë OE në procedurë kërkojmë modifikimin e standarteve si më poshtë vijon:

- Artikulli 1: Pajisja duhet të jete konform EN 12390-4 dhe EN 772-1 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 2 : Te jete konform standarteve EN 196-1, ISO 679, EN 196-8 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 3: Pajisja duhet të jete konform standardeve EN ISO 6892-1, EN 7500-1 ose ekuivalent.
- Artikulli 4: Aparat Vikat për matje Sipas Standartit EN 196-3, , EN 13279-2 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 14: Kroxholat të jene konform standardeve EN 12592, ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 18: Furre sipas standardeve EN 932-5, EN 1097-5, ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 19: Pajisja të konform standartit EN1097-2, EN 12697-17, EN 12697-43 ose SSH/ISO ose ekuivalent.
- Artikulli 20: Te jete konform standartit EN 933-3, ose SSH/ISO ose ekuivalent.
- Artikulli 21: Tundes elektromekanik për sita sipas standartit EN 932-5 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 23: Pajisja të jete konform standardeve: EN 1097-3, ose SSH/ISO ose ekuivalent.
- Artikulli 24: Pajisja duhet konform standardin EN 933-4 ose EN 933-5 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 25: Sipas EN 933-8 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 27: Struktura e fortë e krijuar për të vendosur peshoren elektronike sipas standarteve EN 12390:7 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 28: Përdoret për të përcaktuar peshën specifike të çimentos hidraulike dhe gëlqeres sipas standarteve EN 196-6 ose SSH/ISO ose ekuivalent
- Artikulli 33: Pajisja duhet të jete sipas standarteve EN 1916 e krahasueshme me ASTM C301, ose SSH/ISO ose ekuivalent

Artikulli 1. PRESA AUTOMATIKE MULTIFUNKSIONALE PËR BETONIN

1.1 - Është kërkuar:

Të jetë me rezolucion të lartë dhe të paktën 6-8 kanale analoge të përshtatshëm për sensor ngarkesë ose zhvendosje.

Gjithashtu kërkohet,

Të jetë e pajisur me njësi kontrollit për të menaxhuar deri në 8 kanale me rezolucion të lartë për kontrollin e qelizave të ngarkesës ose transduktorëve me urë matëse tensioni.

Specifikimi i kërkuar është i njëjtë dhe i shprehur 2 herë në formë të ndryshme.

Kërkojmë që specifikimi: Të jetë e pajisur me njësi kontrollit për të menaxhuar deri në 8 kanale me rezolucion të lartë për kontrollin e qelizave të ngarkesës ose transduktorëve me urë matëse tensioni.

Të hiqet ose të shprehet si më sipër kërkuar: 6 – 8 kanale.

Artikulli 3. PRESE PËR PROVAT NË TËRHEQJE TË CELIKUT DHE PËRCAKTIMIN E REZISTENCËS NË PËRKULJE TË CELIKUT

3.1 Është kërkuar:

Të jetë me rezolucion të lartë dhe të paktën 6-8 kanale analoge të përshtatshëm për sensor ngarkesë ose zhvendosje.

Gjithashtu kërkohet,

Të jetë e pajisur me njësi kontrollit për të menaxhuar deri në 8 kanale me rezolucion të lartë për kontrollin e qelizave të ngarkesës ose transduktorëve me urë matëse tensioni.

Specifikimi i kërkuar është i njëjtë dhe i shprehur 2 herë në formë të ndryshme.

Kërkojmë që specifikimi: Të jetë e pajisur me njësi kontrollit për të menaxhuar deri në 8 kanale me

rezolucion të lartë për kontrollin e qelizave të ngarkesës ose transduktorëve me urë matëse tensioni te hiqet ose të shprehet si më sipër kërkuar: 6 – 8 kanale

3.2 - Është kërkuar:

Programi të lejoj përcaktimin e modulit fillestar dhe të stabilizuar siç kërkohet nga standardi EN 12390-13.

Kërkojmë të hiqet si specifikim pasi standarti EN 12390-13 nuk është standart që aplikohet në testimin e celikut por është standart për mostrat e ngurta cimento/beton si më poshtë referuar: (EN 12390-13 specifies a method for the determination of the secant modulus of elasticity in compression of hardened concrete on test specimens.)

Artikulli 6. TAVOLINË PËR KONSISTENCËN E LLAÇIT

Është kërkuar:

Pajisje e cila përdoret për përcaktimin e konsistencës së llacit dhe gelqerës conform EN459-2 dhe EN1015-2 ose ekuivalent.

Kërkojmë ndryshimin e standartit EN1015-2 në EN1015-3 pasi standarti i kërkuar nuk aplikohet për përcaktimin e konsistencës së llacit të freskët.

Si më poshtë referuar standartit:

(Determination of consistence of fresh mortar (by floë table): BS EN 1015-3 The floë value is determined by measuring the mean diameter of a test sample. The bulk sample of fresh mortar is reduced to a minimum sample size of 1.5 litres. Është the floë of dry mortars is being measured, these should be mixed either in accordance with BS EN 1015-2.)

20. KLASIFIKUES I MOSTRAVE ME KAPACITET TË MADH

Është kërkuar:

E ndërtuar nga material i forte totalisht i galvanizuar kundër koorrodimit.

Ky specifikim teknik është kufizues. Duke qënë që prodhues të ndryshëm e shprehin në mënyra të ndryshme, në mënyrë që të hapet konkurrenca pa ndikuar në funksionalitetin, standartin e aplikuar dhe saktësinë e rezultateve të testimit kërkohet që specifikimi të bëhet:

E ndërtuar nga material i forte celik i galvanizuar ose ekuivalent

21. TUNDËS I MOTORIZUAR I SITAVE

Është kërkuar :

Tundës elektromekanik për sita sipas standartit EN 932-5, ISO 3310-1

Vëmë në dukje që standarti ISO 3310-1 si më poshtë referuar:

(ISO 3310-1:2016 - Test sieves of metal wire cloth) nuk është standarti që aplikohet për pajisjen – "Tundës i sitave" por standart i sitave që vendosen në tundës dhe që janë artikull me vetë në listën e tenderit (Art. 17).

Kërkojmë të bëhet: Tundës elektromekanik për sita sipas standartit EN 932-5 ose ekuivalent.

Në specifikime teknike është kërkuar:

Kapaciteti: të mbaje të pakten 10 sita me diametër 300/315 mm

Gjithshtu është kërkuar që: Të jete me vibrime vertikale, Laterale dhe rrethore

Vëmë në dukje që kapaciteti për 10 sita nuk është për sitat 300/315mm por kur përdoren sitat me diametër më të vogël.

Nuk ekzistojnë tundës që të kryjnë vibrime vertikale, Laterale dhe rrethore dhe të mbajnë 10 ose më shumë sita me diametër 300/315mm. Nëse ky pretendim nuk qëndron AK të paraqesë 3 modele të prodhuesve të ndryshëm që plotësojnë specifikimet e kërkuara.

Të jetë me vibrime vertikale, Laterale dhe rrethore

Kapaciteti: të mbaje të pakten 10 sita me diametër 300/315 mm

Në mënyrë që për të hapur konkurrencën specifikimi i kërkuar të bëhet:

Kapaciteti: të mbaje të pakten 6 sita me diametër 300/315 mm

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@krijon.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Xhuljana Braha